



Shkolla fillore komunale “Liria” Shkup – Општинско основно училиште „Лириа,, Скопје

Cvetan Dimov 94 , tel./fax: +389 2 2611 854 – Цветан Димов 94 , тел./факс:+389 2 2611 854, e-mail:liria\_shkup@live.com

---

## KODEKS I SJELLJES SË ARSIMTARËVE GJATË MËSIMIT ONLAJN

- Ky lloj I mësimi zgjatë deri sa zgjatë gjendja e pandemisë COVID 19 dhe është lloj formal I mësimi I miratuar nga ana e MASH-it.
- Çdo arsimtar është I obliguar ta realizon mësimin onlajn.
- Çdo arsimtar ta realizon mësimin sipas orarit të rregulltë.
- Çdo arsimtar është I obliguar të mban dosjë-ë për çdo nxënës ku do ti mbledh dëshmitë e nevojshme për notim formativ dhe sumativ.
- Çdo arsimtar është I obliguar të jep informata kthyesë për nxënësit dhe prindët.
- Nuk është e lejuar të bëhet distribuimi I materialeve që janë pjesë e mësimi të nxënësve me qëllim të mbrohët privatësia e nxënësve.
- Nuk është e lejuar të bëhet distribuimi I materialeve, instrumenteve,dokumenteve(lista evidentuese që I përdor shkolla për mbledhjen e të dhënave).
- Arsimtarët mund të incizojnë dhe bëjnë fotografi vërtëm për përdorim intern dhe si dëshmi,por nuk është e lejuar shpërndarje në rrjetët sociale.
- Gjatë kohës së mësimi online arsimtarët e tregojnë profesionalitetin e vet.

Drejtor

---

/ Teuta Idriz /



## **SI DO TË SILLEN PRINDERIT , BASHKËPUNTORËT E JASHTËM DHE PERSONAT E TJERË**

- Ardhja e prindërve në shkollë është e rregulluar me planin për mbledhje prindërore.
- Gjatë vitit shkollor janë planifikuar minimum 4 mbledhje prindërore, sipas nevojës edhe më shumë .
- Takimet individuale të arsimtarëve me prindërit do të realizohen sipas orarit të arsimtarëve për ditet e pranimit dhe sipas nevojës.
- Mbledhjet grupore realizohen sipas nevojës.
- Për nevoja urgjente prindërit ose shkolla kërkon kontakte të jashtëzakonshme.
- Këshilli I prindërve në nivel të shkollës, takohet sipas planit dhe programës për punë të këshillit të prindërve për vitin vijues, e organizuar dhe me ftesë të kryetarit, në kohë paraprakisht të caktuar në koordinim më drejtorin duke I respektuar protokolët e MASH.
- Mbajtja obligative e maskave.
- Prindërit jashtë kohës së planifikuar nuk duhet të qëndrojnë në shkollë.
- Prindërit janë të obliguar të kenë raporte korekte më të punësuarit e shkollës.
- Prindi , mvarësisht nga nevojat personale , mundë ta sjell dhe merr fëmijun e tij , por vetëm në oborin e shkollës, me përjashtim për nxënësit më NVA.Sjellja e nxënësve me vetur dhe parkimi I veturave të tyre prindërit duhet ta bëjnë në rrugën e asfaltuar dhe jo para hyrjës dhe oborrit të shkollës.
- Varësisht nga nevoja e shkollës qëndrojnë dhe persona tjërë dhe bashkëpunorë të jashtëm.
- Qëndrimin e tyre e lajmërojnë te arsimtari kujdestar, sekretari, shërbimi profesional ose drejtori I shkollës.
- Prindërit , bashkëpunorët e jashtëm , mvarësisht nga dëshira dhe nevoja e shkollës, mundë të jënë prezent në orë ose aktivitete të tjëra, por me marëveshje paraprake me kujdestarin e klasës, arsimtarin lëndorë, bashkëpunorët profesional por vetëm me lejën e drejtorit të shkollës. Angazhimi I prindërve , bashkëpunorëve të jashtëm në shkollë do të jetë e rregulluar me dokument të posaçëm – udhëzim për punë.

Drejtor

---

/ Teuta Idriz /



## KODEKSI I SJELLJES SË NXËNËSVE GJATË HYRJES DHE DALJES

- Ky lloj I mësimi zgjatë dëri sa zgjatë gjëndje e pandemisë KOVID 19 dhe është lloj formal I mësimi I miratuar nga ana e MASH-it.
- Nxënësit në shkollë vijnë më së shumti 15 min para fillimit të mësimi - aktiviteti të planifikuar.
- Nxënësit në shkollë detyrimisht do të mbajnë maska, Në shkollë do të hynë një nga një dhe janë të detyruar të mbajnë distanc prej 1,5- 2metra.
- Nxënësit që nuk kanë maska nuk do të ju lejohet të përcjellin mësimin me prezenc fizike.
- Nxënësit gjatë hyrjes dhe daljes detyrimisht duhet ti dezinfektojn duart dhe këpucët,
- Qëndrimi I nxënësve ne kohë është I rregulluar me organizimin e punës në ndërrime ,orari I mësimi , dhe orari I aktiviteteve të tjera , dhe orari I ziles.
- Ndalohet qëndrimi I nxënësve në shkollë dhe oborin e shkollës , jashtë organizimit të planifikuar.
- Nxënësi I cili e ka të rritur temperaturën mbi 37.5 mënjëher izolohet në hapsirë të veçantë.
- Lajmërohet prindi ose kujdestari dhe rekomandohet që të shkonë te mjeku amë.
- Pas mbarimit të aktiviteteve te planifikuara nxënësi largohet nga shkolla.
- Çdo nxënës gjatë qëndrimit në shkollë duhet të sillet korrekt dhe ta respekton rendin shtëpiak.
  
- Gjatë pushimeve nxënësit lëvizin sipas rendit të caktuar, varësisht nga orari I mësimi dhe aktivitete të tjera dhe ajrosin klasën.
- Lëvizja në korridorë realizohet me rend dhe disiplinë.
- Dalja dhe hyrja në shkollë dhe klasë poashtu realizohet me disiplinë dhe duke I respektuar protokolet.

Drejtör:

/Teuta Idriz /